ADEM ZAPLLUZHA

LËRENI ZËRIN TIM

Redaktore:
Shabaze Vishaj - Grajçevci

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Jusuf Grajçevci

ADEM ZAPLLUZHA

LËRENI ZËRIN TIM

Shoqata e Shkrimtarëve
“Fahri Fazliu”
Kastriot, 2014

KËNGËTIMI POETIK I ADEM ZAPLLUZHËS, PASQYRIM I BOTËS REALE

Kur flasim për vargun poetic të poetit Adem Zaplluzha, kemi parasysh se kemi të bëjmë me një krijues të mirëfilltë, i cili deri më tani ka botuar 103 vepra. Këngëtimi i tij poetik në veprën letrare"Lëreni zërin tim" është pasqyrim I botës reale, preokupimi I poetit dhe shqetësimi për gjithçka që e rrethon atë shoqërinë dhe popullin në përgjithësi.

Nisur nga titulli i këtij vëllimi "Lëreni zërin tim" shihet qartë se kemi të bëjmë me porosi të veçanta për lexuesin. Motivet dhe temat e trajtuara në këto lirika janë të llojllojshme, e që shumë sish vejnë në pah brengën,mllefin, dashurinë, mallin për gjithë atë që rrethon botën njerëzore. Pra zëri i tij protestues, shfaqet me nota dhembshurie , dhe të ashpra, me qëllim që përmes vargut të ndikoj në mendjet e atyre që me vetëdije hapën plagë të pashlyeshme në jetën njerëzore. Se vërtet Adem Zaplluzha është zë kryengritës në këtë vëllim poetik dhe është vetë shpirti i popullit flasin edhe vargjet në vijim të poezisë "Vargu im":

Vargu im kryeneç
Sa shumë i përngjan shpirtit të popullit
Saqë pa të kurrë nuk mund të qëndrojë
aq fort në këmbët e veta

Më tej poeti ligjëron për dërrasat e mykura të kujtesës, drerin e pikëlluar e anijet e mbetura në mol. Te poezia : Shirat e një vjeshte vargjet e thurura me mjeshtri dhe të gdhendura me mature flasin qartë për origjinalitetin poetik si në lirikat vijuese:

Sonte po troket vetmia
Po troket si dikur shirat në xhamat e kujtesës.

Ose,kur thotë:

Eja miku im eja ,kjo natë ka zënë e po i. kafshon mollët.

Revoltën kundër dukurive negative dhe atyre që shkelin mbi të pafajshmen poeti Adem Zaplluzha e vë në pah me figura stilistike që e ngritin veprën në nivel të lartë ideoartistik.

Ja si ligjëron poeti:

Ndoshta vetëm juve/ U takojnë privilegjet të jeni të trishtuar/ nën mëngët e këmishës/ asnjëherë s'pushojnë së kafshuari /erërat e çmendura të jetës/

(Te poezia Loti) si për shumë poet të tjerë edhe për Adem Zaplluzhën plaga e azilkërkuesve është plaga e pashërueshme, ku ai me mjeshtri poetizon në poezinë "Kur kthehen" / Miqtë e mi

azilkërkues/Përherë janë të trembur/Netët iu kalojnë nën ndonjë urë/Ku urinojnë zogjtë e natës/…

Ndërkaq mosha e fëmijërisë poetit i sjell ngrohtësi dhe nostalgji për të, ku me lirizëm shprehet:

/Po ikën fëmijëria/ po largohet si hije pa ngjyrë/po këputen degët e mëllagës së kuqe/…Lirikat e poetit Adem Zaplluzha lexuesin e bëjnë për vete.

Mbresa të veçanta të lënë ato të dashurisë, veçanërisht te poezia "Më prit se unë do të vij, sidomos vargjet Më prit te shelgjishtet/ unë do të vij/ hape kraharorin /hape zemrën tënde të madhe/ për shpirtin tim të vogël/

Siç shihet e poetit shpërfaqet jo vetëm shpirti i trazuar, por edhe i gjithë popullit,ndaj me të drejtë mund të thuhet se përmes brendisë shpirtërore të poetit lexuesi e kupton brendinë shpirtërore të popullit Shqiptarë

Shabaze Vishaj- Grajçevci
Prishtinë 2 prill 2014

Lëreni zërin tim
Cikli i parë

VARGU IM

Vargu im
Ti po i përngjan shpirtit tim rebel
Nga çdo fjalë
Si zogu i shenjtë
Çel nga një rresht kryengritës

Vargu im
Furtuna dhe zgërbonja e lisit
Herë vetëvritet
E herë ngritët në maja të degëve

Ecën në dy këmbë të shëndosha
Kur frynë erërat
Pa dashje kërthndezesh
Shkon te lumi deri në pambarim

I njeh të gjitha rrugët e karvanëve
Që hynë dhe dalin
Nëpër shpirtin e rrugës së lashtë
Via Egnatia

Për përgjumjen time këndon si çdo arabaxhi
Kur zbresin djajtë te biga e qerres
Ajo trishtueshëm hingëllon
Sa që i vret në degët e shpirtit
Kukuvajkat e vetmuara

Vargu im
Këndon si shpirti i trishtuar i varrit
Sa herë që zgjohem pa të
Disi ndjehem i zbrazët si era e plagosur

Vargu im
shpirti im i zbrazët
Dhe fryma ime kryengritëse
Që pandërprerë ulërinë në maja plepash

2.

Vargu im rebel
Flenë nëpër zgërbonja fjalësh
Në rast se zgjohet
Ulërinë si shpirti malit
Edhe kur fle i përngjan ortekëve

Mbështetet në njërin sy
Kurse tjetrin e lë të hapur si mendjen
Sa herë që i afrohen tufanet atdheut
Ajo zgjohet
Si nga baladat zgjohet
Dhe u del përballë furtunave

Vargu im kryeneç
Aq shumë i përngjan shpirtit të popullit
Sa që pa të
Kurrë nuk do të mund të qëndroj
Aq fort në këmbët e veta

3.

Vargu im
Qenie me shtatë shpirtra
Herë i përngjan dashurisë
E herë urrejtjes

Një ditë i përngjan puhizës së pranverës
Kurse ditën tjetër
Ashpërsohet si Sharri dinak
I bart mbi supet e dërmuara
Të gjitha dashuritë dhe trishtimet e botës

Vargu im
Shpirti dhe kënga e erës
Fjollë e kristaltë dëbore
Në maja të kallkanëve
Kur dimri frynë me tërë ashpërsinë
E maleve krenare

TË PRES

Nesër të pres
Me dritare të hapura
Ti eja e dashur
Eja me djersët e para të vesës

Të pres si toka e etur shiun
Zbrit nga ato mjegulla të bardha
Del të lutem nga flluskat e reve
Që pluskojnë dashuri

Të thash se të pres
Eja nëse vonohen shirat
Erërat mund t'i thyejnë dritaret
Eja të lutem
Po deshe edhe me stërkala lotësh

Ti vetëm eja e dashur
Po që se nuk vjen
Çfarë të bëjë me xhamat prej rëre
Të shpirtit tim të thyer

Prishtinë, 05 janar 2014

GJERDANE TË KRISTALTA LULESH

Je njeri prej mishi
Ose fryma e një shpirti
Zogu që fluturon hapësirave
Mbase grua e lindur të më inspiron

Nga çdo fjalë e jote
Si kryqi im ringjallet etja
Për stinët e mia të bukura
Prej flokëve tua të mëndafshta
Thurë gjerdane të kristalta lulesh

Ti etja ime e pashuar
Në secilin hap të ditës
Çel nga një zambak i bardhë
Ku si nga një ëndërr e mirë
Zgjohet dashuria

Në çastin kur mbërrin tek unë
I shëron plagët e dukshme
Dhe ato të padukshme
të pritjeve

Ti grua që i inspiron mjegullat
Kur nga shpirti yt
Si zogjtë e shenjtë
Çelin fjalët disa lloje lulesh

SHIRAT E NJË VJESHTE

Sonte çdo gjë fundoset
Fundoset si vaporët e braktisur në mol
Një pulëbardhë po qanë
Me lot deti po dënesin meduzat

Ti ishe fjala ime e parë
Dhe e fundit
Dërrasat e mykura të kujtesës
Si leckat e fëmijërisë notojnë liqeneve

Një dre i pikëlluar
Po qan si një njeri i harruar
Po qan si era tangoja e fundit në shi
Kujt i duhet kjo ngrysje
Në skamjen e shpirtit
Të qiellit tim

Po bien
Si meteorët po bien
Shirat e një vjeshte
Anijet e ankoruara
Akoma paskan mbetur në mol
Të kujt janë këta lot prej mjegullave
Që më ngufasin në këto çaste

EJA MIKU IM

Eja miku im
Eja të dehemi sonte
Jo me verën e kuqe të vreshtave tona
Por me dhembjen time

Sonte po troket vetmia
Po troket si dikur shirat
Në xhamat e kujtesës
Eja miku im
Eja me zërin e ndërgjegjes
Mos më lërë në këtë gjendja

Kam të ftohtë
Më djersiten duart në shi
Çatitë pikojnë një lloj balsami
Nga ullukët e vjetër
Po pikojnë manaferrat e zeza

Eja miku im eja
Mos më lërë kështu të vetmuar
As kjo gotë më nuk po më duron
Asgjë nuk është siç duket
Kjo natë ka zënë e po i kafshon mollët

JAM OSE DUHEJ TË ISHA

Jam kryqi me të cilin
Më gozhduan
Unë kisha etje
Me një hinkë plastike ma shpuan kafkullin
Më ngopën me pangopësinë e etjes

Desha të këlthas
Ose t'i imitoj krakëllimat e korbit
Një krakëllimë pakëz më ndryshe
Ma ndryshoi mendjen
I humba të gjitha zërat e njohur

Jam ose isha dikur kryqi
Që mbillej në çdo varr
Ku banonin siluetat e vdekura

Sot dukem
Si një skelet dinozauri
I harruar nga të gjithë banorët e hijeve

Eci udhëve
Si drurët pa gjethe eci ledheve
Të së kaluarës

As hije më nuk bëj
Jam ose duhej të isha
Po ato dy trekëndësha magjik
Që krahasohen
Me pjellshmërinë e mjegullave

Prishtinë, 06 janar 2014

ME AVION PREJ LETRE

Njerëzit udhëtojnë
Udhëtojnë për çdo ditë
Me disa lloje valixhesh
Me avion prej letre
Dhe duralumini

Udhëtojnë me shpresa të thyera
Nëpër skutat e harruara
Të kësaj bote gënjeshtare

Nuk lënë vend pa prekur
Ecin shëtitoreve
Si kukullat e dehura nëpër metropole

S'ndalen në asnjë lima
Jo që janë të dashuruar pas udhëtimeve
Por kanë diçka të tillë në gjak
Që i përngjan ikjes së merimangës
Nga një rrjet i punuar me vite

Njerëzit udhëtojnë
ose largohen nga vetvetja
Nëpër tërë gjeografinë e jetës
Kalojnë zbathur

Për të mbërri tokën e premtuar
Nuk ndalen askund
Derisa në fund të udhëtimit
Shndërrohen në përmendore
Të ftohta prej mermeri

SËRISH PËR STINËT NË QYTETIN TIM

Kur dal në shëtitje mes stinëve
Nuk di se cila është më e bukur
Pranvera i derdh në prehër të ylberit
Të gjitha aromat e botës

Vera si sirenat e përrallave
Del mbrëmjeve nëpër mole
Del dhe pret kthimin e peshkatarëve
Stina e cila i përngjan Penelopës

Eh vjeshta kjo nuse e pjekur
I përkund gjethet e zverdhura
Si një nënë e mirë këndon ninulla
Rrënjëve të mos mërdhin nga acari

Kurse dimri si më i moshuari
Pjalmon fjolla të bardha bore
Që i përngjajnë
Flokëve të thinjura të zanave

Të gjitha stinët janë të bukura

ËNDËRRA

Mbrëmë desha të hyj
Sa shumë dëshirova të futem tinëzisht
Nëpër portat e gjumit
Dhe të depërtoj
Si një hajdut i rryer
Deri te ëndrra ime e përgjumur

T'i preki
T'i ledhatoj me këta gishta skelet
Petalet e zbërthyera
Të fëmijërisë

Të zbres deri të rrënjët
Ta përjetoj lindjen e një dite të re
Si asnjëherë më parë
Ashtu siç shihet vetëm në ëndrra

Mbrëmë desha
Oh sa shumë dëshirova
Të jem pjesa e gjumit tim
Të fle po me atë ëndërr
E cila nuk më linte rehat
As në adoleshencën time

ENDE KJO FOTOGRAFI

Ende kjo fotografi
Paska dhembje në sy
Kush e theu kornizën
kur nata e mbushur me yje qante
Si një kërthi i braktisur

Ende kjo fotografi
Rri gozhduar si kryqi
Drurët gjatë tërë kohës
Dënesën mbrëmë
Për fatin e zogjve shtegtarë

Po bie shi pa reshtur
Po këputen meteorët me bisht
Ky qiell i vranët ende po dënesë
Asnjë flutur nuk ka mbetur
Nëpër këto katete kujtimesh

ATË MAL PREJ GURI

Edhe këtë ditë
E barta mbi shpatulla
E ajo kaloi ashtu siç kalojnë hijet
Vetëm disa zgërbonja të zeza
Po hapen në kavernat e damarëve

Edhe një ditë
E ajo do të jetë e nesërmja
Që duhet bartur siç e barte Sizifi
Atë mal prej guri
Deri te majat e përtejme
E barte për të dal nga përralla

Edhe një ditë
Si të gjitha ditët do përfundojnë
Fillimet e atyre ditëve
Që janë duke ardhur
Dhe sërish do t'i presim ditët në vijim

Dhe një ditë
Do të presim ty të kthehesh
Me ninullat e fëmijërisë
Dhe qeshjen e erës
Që ka filluar të lozi
Mbi degët e gështenjës së egër

KUR NUK DO TË JEM

Atë ditë kur s’kam me qenë
Në mesin e juaj
Me siguri do të më gjeni
Te ndonjë vjeshtë
Ose te stoli i parkut të vjetër

Mbase aty do të më gjeni
Me të gjitha ëndrrat
Dhe kashelashat e mia
Vetëm këtu pranë këtij stoli
Asnjëherë nuk më ka penguar shiu

Edhe unë i kam përrallat e mia
Do u tregoj miqve të fëmijërisë
Për dashuritë
Do u tregoj për çdo ngjarje
Që i kam përjetuar
Pranë kovave të urinimit

Atë ditë kur s’do të më gjeni
As te stoli
Mund të më kërkoni në qytetin e varreve
Me siguri atje mund të me gjeni
Duke shkruar ndonjë epitaf
Për miqtë e mi

NUK I BESOJ ASKUJT

Nuk të besoj
Të kam thënë njëherë
Mos u lut për mua as për askënd
Lutu vetëm për lëkurën tënde
Fjalët e tua mbesin në ajër
U përngjajnë zogjve të pashpresë

Ti e dashura grua
As për vetvete mos u lut
Mund të këndosh ndonjë psalm
Era i merr ato
Dhe i dërgon diku mes mjegullave
Ua shpërndan engjëjve
Të mos vdesin si ikonat në kornizë

Nuk i besoj askujt
Librat e shenjtë
U përkasin atyre të gjallëve
Të vdekur
Që thurin tregime të bukura
Për botën e nëndheshme

Unë nuk i besoj askujt as vetvetes

ASNJË ËNDËRR NUK MË VJEN

Në këtë gjumë të përdalë
Asnjë ëndërr nuk më vjen
Çfarë të bëj
Me këtë zbrazëti të zbrazët
Ku nuk mund t'i gjej as duart e erës

Po bie një lloj shtreze e murrme
I lagu të gjitha muranat
Si ta ndryshoj emrin e kësaj rruge
Kur as vet
Nuk kam emër e as mbiemër

Vjeshta paska mbetur në hyrje të qytetit
Dimri s'duket askund
Shkundjet e gjetheve të zverdhura
Zhduken pas maleve
Shelgjishtet e pikëlluara po qajnë si kalama

Po ikin edhe zogjtë shtegtarë
Mbase i kanë lënë vezët
Në ndonjë metropol
Të çelin trishtim prej zogjve
Të mbetur ullukëve të mallkimit njerëzor

PO THONË METEROLOGËT

Nëse më zgjon e dashur
Lëre ëndrrën time të varur
Si harpën
Në ndonjë degë të kujtesës
Nesër është një ditë pak më ndryshe

Sonte është vonë
Kurse nesër
Tepër herët për të më zgjuar
Vari në degët e mollës parathëniet
E tregimeve të pashkruara

Nëse shirat e ndërrojnë mendjen
Dhe kalojnë këndej pari
Ti lëri shtambat e zbrazëta
Te lama e Ukës
Se duhet të kemi ujë të bollshëm
Për këtë dimër

Po thonë meteorologët
Se sivjet do të ngrihet edhe ajri
E ne duhet ta përballojmë dimrin
Siç i kemi përballuar
Edhe stinët me të egra gjatë shekujve

Prishtinë, 08 janar 2014

KY TREN I ÇMENDUR I MARSIT

Pranë nesh ngricë e paparë
Jashtë te portat e thyera
Si një bishë e egër
Ulërin murrlani

Një dru i zhveshur lakuriq
Ecën me kujdes dhelpre
Ecën nëpër akullin e kristaltë
Mbi shtreza flokësh frynë një erë e fortë

Mbase ky mars i sivjetmë
Po i përngjan njeriut të borës
I pashpirt si kallkanët
Vetëm zëri i çative rëndohet nga pesha

Një frymë e akullt kristalor
Frynë nëpër zgavrat e kokës sime
Frynë si mendimet e shthurura
Kurse e nesërmja fare nuk ekziston

Sërish era s'pushon
Merr frymë si njeriu i lodhur
Jashtë murrlani fërshëllen
Nëpër binarë pjalm të kuq gjaku
E fjolla të zeza bore

Dëgjohen piskamat e fëmijëve
S’ndalen as vajet e nënave
Kur do të mbërri deri në Bllace
Ky tren i çmendur i marsit

NË BALLË ME VARRTARIN

Si njerëzit ecin varret
Prej një ane
Mbërrin në anën tjetër të qyteti
Në ballë me varrtarin
Parakalojnë kolona skeletesh

Mes drurëve dhe kolonadave
Të mermerta
Ecin varret dhe njerëzit
Ecin me kryeneçësinë e erës

Mbi njëmijë vjet e më shumë
Zgjatë ky udhëtim
Ecin e ecin
Varret dhe varrtarët nëpër histori

Një lumë idhnak shkon deri te përroi
Depërton përtej mundësisë së ujit
Shushurima e gjetheve
Si era e tërbuar fërshëllen

Ecën lumi njerëzit dhe varret
Nuk ndalen askund të pushojnë
Ose të marrin pak frymë
S’ndalet askund ky vargan prej eshtrave

Cikli i dytë

KUJT PO I MBETET KY ATDHE

Nëpër rrugë kalojnë
Njerëzit dhe drurët e përgjumur
Gjethet e verdha të vjeshtës
Në një kor madhështor
Mbajnë në shpirt ison e trishtimit

Këto rrasa të kuqe mermeri
Skalitur në mendje bartin një frikë
Ecin duke vajtuar
Kanë një parandjenjë
Sa të mermertë po aq edhe njerëzor

Shiu pa reshtur bie me stërkala
Këputen edhe meteorët
Vetëtimat po i shqyejnë
Perdet veç të grisura të qiellit
Retë e zeza
Si korba të sëmur kanë zbritur në tokë

Nëpër rrugët e leckosura ikin qentë
Ikin diku edhe nënat
Me nga një
Ose më shumë fëmijë në grykë

Në mendje të njerëzve
Ndoshta një tokë e premtuar
Po largohen pa ditur
Se kujt po i mbetet ky atdhe i zhuritur

SONTE

Sonte zemra ime po i përngjan
Një dhome të zbrazët
Shakullina si e çmendur
Sillet vërdallë rreth mureve
Lagështia nuk më lë të marr frymë

Qaj me zë të lartë
Askush nuk dëgjon oshtimën e erës
Një grua kryeneçe ecën
Me taka prej plastike
Kalon mbi trupin tim të moshuar

Si një lumë i dalldisur
Fryhen damarët
Shkulmat e gjakut i spërkasin muret
Çfarë po ndodh me pemën
Që nuk dha as një frytë sivjet

Sonte nuk qenka si netëve të tjera
Sa shpejt ndryshojnë gjërat
Në mënyrë marramendëse
Fluturojnë zogjtë
Fluturojnë pa kurrfarë qëllimi
Nëpër zbrazëtin e thyer të shpirtit tim

DITA E MBARË

Më duket se
Si ëndrrat po bien njerëzit
Po bien edhe perëndit
Një nga një po dorëzohen idhujt

Edhe librat e shenjt i kanë lëshuar flamujt
Në gjysmështiza
Nuk ndalen as vajet e ikonave
Një varr i imagjinuar
Kafshon kryqin

Hej njerëz
Mos më prekni në këtë çast
Kjo ditë është e gjatë
Më e gjatë
Se sa rruga e Golgotës

Atje në maje buzëqeshje gjethesh
Një siluetë
I përshëndet drurët
Prej zgërbonjës së një kafke
Fluturuan dy pëllumba
Dita e mbarë
Për herë të parë i hapi sytë

PËRPOS TË FRYMOJMË

Kur jemi të lodhur
Tentojmë të ecim
Mbi buzëqeshje gjethesh
Me shpirtin e dërmuar të degëve
Krahasojmë erën

Ecjen e kemi të ngathtë
Nuk di
Se kujt i përngjajmë
Por nuk jemi vetvetja e jonë
Në ecjen horizontale rrëshqasin këmbët

Kur shtrihemi për toke
Mbase edhe na pëlqen një gjendje e tillë
Nuk mendojmë për asgjë tjetër
Përpos të frymojmë
Nëpër trishtimin e horizontales

Prishtinë, 09 janar 2014

JASHTË KËSAJ BETEJE

Njoh disa njerëz
Që ecin si kuajt e egër
Ecin drejtë një beteje
Që akoma nuk ka përfunduar

Era si përherë
Loz bixhoz me fatin e dizgjinëve
Tregimi këtu fillon
Kur I afrohemi fundit të betejës

Njoh edhe disa lloje të kuajve
Që hingëllojnë si nata
Kur perëndon dielli i fundit
I një lufte të tmerrshme

Nën shalat e përgjakura të betejës
Era si ariu i tërbuar
I lëpinë plagët e një dite
Që s'dihet se kur përfundon

Kurse dielli i shastisur
I ka humbur të gjitha udhët
Me gjasë
Sonte do perëndoj në lindje

Këtu posa kanë filluar të bien kokat
Të bien në fushën e bejlegut
Ashti siç kanë rënë
Perëndit në Olimpin e çmendur

Jashtë kësaj beteje
Mbi telat e ndryshkura me gjemba
Presin korbat për ta shqyer
Njëherë e përgjithmonë pajën e luftës

ASKUSH NUK BANON ATY

Ka raste kur fshihemi
Pas përgjumjes së mjegullave
I thërrasim shirat kur kemi etje
Por askujt
Në këtë qytet
Nuk i intereson zëri im

Bredhi rrugëve qorre
Ku më përqeshin portat e mbyllura
Edhe ato që hapen shumë rrallë
I gjuaj me gur dritaret
Mbase atje nëpër dhoma
As që ekzistojnë njerëzit

Më thanë se
Askush nuk banon
Në këto lagje të braktisura
Unë si zakonisht
Shumë pak u besoj njerëzve
Kështu më ka mësuar qeni im

Prej një porte të mbyllur
Kaloj në portën tjetër të hapur
Trokas si i çmendur
Askund s'dëgjohen zërat

Pas dyerve të mbyllura
Nga brenda
Një zë siluete
Por edhe ai u përngjan
Çative të rrënuara
Para meje ecën miku im
Me bastunin e gjyshit tim

KUR KTHEHEN

Miqtë e mi azilkërkues
Përherë janë të trembur
Jetojnë si hijet e zeza
Mes shiringave
Dhe ditëve të trishtuara

Ngjan që netët i kalojnë
Nën ndonjë urë
Ku urinojnë zogjtë e natës
Çdo këshillë për ta
I ngjan çekiçit që u bie për koke

Janë aq të vetëdijshëm
Sa që humbin rrugëve
Humbin
Si shurra e pulës së verbër

Kur kthehen në shtëpi
Nëse i qëllojnë portat e duhura
Kush e di se ku
U ka mbetur çelësi i deriçkës

Prishtinë, 10 janar 2014

MUZIKA E CIGANËVE

Ciganët janë njerëz të pashoq
Flenë me muzikën
Dhe kur zgjohen në mëngjes
Bisedojnë
Me ëndrrën e trishtë të gërnetës

Vetëm pas përfundimit të këngës
Nënat cigane i lindin fëmijët
Duke kënduar
Në secilën sisë zeshkane
Varet nga një qemane

Edhe kur grinden dhe dashurojnë
Ndjejnë epshin e muzikës
Për çdo mëngjes
Në telat e kitarës së vetmuar
Vizatojnë nga një daulle

Muzika e ciganëve
I përngjan frymëmarrjes së erës
Nga çdo ëndërr e zeshktë
Buron nga një melodi
Më e trishtuar se tjetra

Edhe kur i qajnë hallet e varfërisë
Ata me lot mjellme
I këndojnë elegjitë
Dhe serenatat
Nën hijet e çative të rrënuara

Kjo është muzika cigane
Këta janë ciganët

NUK NDALEN AS PATAT E EGRA

Mjellma qan me lot të ngrirë
Nën çati nga kallkanët pikon acari
Era me lotët e saja të kristalta i përngjan
Flokëve me pjalm dëbore

Një dru i veshur si ariu i bardhë
Vjen nga një udhë e largët
Nën qerpikët e mëngjesit fshihen fjollat
Fshihen ëndrrat e përgjumura

Sot më nuk paskam kohë
As për ndonjë bisedë miqësore
Kjo fërfëllizë nuk di të ndalet
Nuk ndalen as patat e egra

Mbase paskan vendosur
Të udhëtojnë nëpër acarin e kësaj nate
Ky dimër i sivjetmë
Pakës më ndryshe na kafshon

Nga oxhaqet e dërmuar
Tymojnë shpirtrat e mjegullave
Drurët dhe njerëzit i përngjajnë njëri - tjetrit
Ecin si arinjtë e Sharrit
Kalojnë me pallto të bardha dimri

ÇELËSI I KËRKESAVE TUA

Përpara bardhësisë së erës
Ishte një tjetër ngjyrë
që i përngjante ujit
Duart e tua preknin lëkurën time
Si uji që i prek brigjet e lumit

Mua më kaplonte një ndjenjë
E paqartë
Më dridheshin gishtat
Si thuprat e thanës
Dridhej i tërë trupi im prej mermeri

Kurse prekjet e tua
Ishin një risi krejt më ndryshe
Mbi lëkurën time të rrjepur

Ti s'dije të ndalesh asnjëherë
Mbase kokëfortësia e jote
Rrinte me ty
Si një oreol magjik në kokën e ikonës

Kurse unë
Isha vetëm një hije e përhumbur
Mes parmakëve të dritares
Ndoshta isha
Çelësi i kërkesave tua

Por isha diçka mes kërkesave
Dhe prekjeve
Të pandërprera të erës

Isha ai që duhej të ishte çdo njeri
Në ato çaste
Kur përjeton ardhjen e zogjve
Mbi degët e një kujtese
Që i përngjanin harresës

SI FËMIJË KËNAQEM

Kanë nisur
E po thyhen imazhet e kristalta
Në çdo çast
Po më ikën fëmijëria

Po largohet si një hije pa ngjyrë
Po këputen degët e mëllagës së kuqe
Çdo gjë duket e largët
E tej e harruar

Si nëpër mjegull më kujtohen
Shkallët e pallatit
Kur i kapërceja
Me një të kërcyer
Nga dy ose më shumë shkallë

Kurse sot po nëpër ato basamak
Më duhet të pushoj
Nga dy e më shumë herë

Ngjan që më mbajnë për dore
Fëmijët e lagjes
Një ngrohtësi e pa përshkruar
Depërton nëpër qenien time

Sot jam tepër i lodhur
Më ushqen një mall i largët
Dhe kënaqem
Si fëmijë kënaqem
Me mirësinë fëmijërore

KOHËRAT QË NUK HARROHEN

Qante gërneta
Si një fëmijë i braktisur qante një melodi
Cigani i dehur nga dashuria
I lëpinte buzët e fishkura të natës

Yjet endacak kishin dal te plepat
Dhe bisedonin si dikur
Kur ne bisedonim
Në kohën e adoleshencës
Ishin ato kohëra që nuk harrohen

Një cigane gjoks fryrë te shkurret
I krihte flokët e mbrëmjes
I krihte
Edhe ato të mjegullave
Në gjoksin leshtor të ciganit plak

Deniku frynte nga të gjitha anët
Frynte një erë e lehtë
Me shije mëllage
Derisa hëna me një shkop magjik
I prekte majat e plepave me dashuri

NJERËZ PA FIJE SHPRESE

Pas një nate të pagjumë
Njerëzit zgjohen
Zgjohen të trishtuar si zogjtë
Në heshtjen e muzikës
I prekin dhembjet e anktheve

Si të shastisur dalin në rrugë
Kanë rrahje zemre
Dridhen si lepuri i sëmurë
Lusin Hyjin tua merë shpirtin
Por edhe Hyji ua ka kthyer shpinën

Përpos lutjeve të kota
Asgjë tjetër nuk u ka mbetur
Vrapojnë rrugëve qorre
Me ëndrra të grisura vrapojnë
Njerëz pa fije shprese
Ngarendin drejtë një gjumi
Te një nate të zbrazët

SËRISH PËR CIGANËT

Askurrë nuk humbin kohë
Janë mjeshtër të mëdhenj
Në rrjepjen e rropullive
Për një gotë të kuqe vere
Ja vënë zjarrin daulles

Posa kthehen në shtëpi
I përngjajnë koçanit të dehur
Në atë ekstazë të gotës
Në gjinjtë e ciganes
Mundohen ta bëjnë tatuazhin e hënës

Kur janë të dehur
Këta njerëz me lëkurë dielli
Si djaj luftojnë
Kundër perëndive

Gratë e tyre të zhveshura
Nga xhelozia
I mbulojnë me lëkurë bualli
Dhe të nesërmen kur u del pija
Pohojnë
Se ishte vetëm një ëndërr e keqe

MOTRA E KUJTESËS

Tërë jetën vrapove rrugëve
Dhe ja fundi është një pjesë e hiçit
Mbaji duart e erës
Në daç të ndalesh te Ura e Gurit
Ku lidhen rrugët

Ty nuk të ka interesuar lumi
Gjatë tërë jetës i shembe urat
Dhe sot ke mbetur
Diku në mes të rrugës së humbur
As vet nuk di se ku je

Ndoshta kjo është ajo pjesë e jetës
Që duhet ta paguash
Askush asnjëherë
Askujt nuk i ka mbetur borxh
Hijeve që na përcollën deri këtu

Ndonjëherë njerëzit me qëllim
Bëhen pjesa e harresës
Nuk di me dashje ose pa të
Por harresa është motra e lig e kujtesës
Që përherë
Të lë në baltë nga e cila dole

Prishtinë, 11 janar 2014

FLOKËT E ERËS

Mos eja ti sonte
Më pritë te shelgjishtet
Se unë do të vij
Nuk ka lidhje që je larg
Më shumë se çdo gjë i dua largësitë

Mos i mbyllë dritaret
Nata e Prizrenit
Sonte do këndoj një serenatë
Do kuptosh
Domosdo do kuptosh
Ardhjen time e lajmërojnë zogjtë

Kur vij nga një rrugë e harruar
Mos mendo për lodhjen
E as djersitjen e mëllagës
Gjatë tërë udhëtimit tim
Kam pushuar në krahët e ëndrrës sime

Ti më pritë si në kohërat e mira
Do i përngjaj njeriut
Që i krihte flokët e erës
Nuk mund të më ndalë deniku
Nga kjo rrugë e largët

Më pritë me porta të hapura
Hape edhe kraharorin
Ku pushojnë ëndrrat e tua
Hape zemrën tënde të madhe
Për shpirtin tim kaq të vogël

KODI I FAMILJES

Sa herë që kthehem në fëmijërinë time
Si sot më kujtohen
Kuajt ngarkuar me dru
Më kujtohet mali i lënduar
Sëpata e vjetër
Duke i kafshuar lisat

Nuk mund ta harroj as udhën e dhive
Kah përbiroheshim
Nëpër hijet e gështenjave të egra
Kalonim ngarkuar me dru frashri
Dimrat ishin të zeza
Dhe të gjatë në vendin tonë

Na mungonte edhe drita
Fshati i jonë
Si të gjitha fshatrat
Notonte në një humbëtirë

Mësimet i mësonim
Nën reflektimet drithëruese të hënës
Në një enë dheu
Mbaruar prej argjile
E mbanim gjallë shpirtin e vajgurit

2.

Kur kishim mysafir të rrallë
I zoti i shtëpisë ndizte nga dy qirinj
Thoshte duhet shikuar mikun në sy

Kurse babai im ndjesë pastë
Pohonte se asnjë muhabet
Nuk bëhet në errësirë

Ky ishte kodi i familjes
Që ja tejkalonte lashtësisë
Së fisit tonë dardan

NUK I PËRNGJAJE ASKUJT

Të kujtohet kur u pamë
I fshehe mustakët e zbardhura
Mes rrudhave të fytyrës

Nga loti yt pikonte ngrica e acartë
Me gishtat e tua mbuluar
Me nikotinë
S'ishe në gjendje ta përdorësh as shiringat

I përngjaje një cope të akullt
Mermeri
Në çdo prekje nëpër trupin tënd
Dallohej një hije e mavijosur

Ti më nuk ishe në gjendje
Të këndosh asnjë serenatë
Nuk i përngjaje askujt
E aq më pak vetvetes

Thanë se
Posa dole nga një spital psikiatrik
Kush e di se ku
E kishe harruar këmishën e bardhë

Ti miku im i moçëm
U ngjize me të paudhët
Ti trishtimi im i fëmijërisë
Që nuk ke shërim as në botën tjetër

MBI ÇATITË E LUMËBARDHIT

Mbi çatitë si zogjtë
Kanë zënë vend fjalët
Dëgjohen ariet e zërit të erës
Bie një shi imcak
Në shpirtrat e pasioneve të përgjumura

Një nënë përqafohet me dashurinë
E saj
Diku te një baladë
Çelin pemët do zogj të bardhë
Nëpër luadhet e pakositura
Thonë se kanë mbirë
Do gjethe të reja tërfili

Edhe në zërin tim po bien të reshurat
Nuk ndalen as zërat e erës
Oshtijnë darabukët
Në të katër anët e qytetit
S'pushojnë daullet e kushtrimit

Mbi çatitë e lumëbardhit
Një kohë të gjatë nuk pushojnë dasmat
Zambakët bredhin sokakëve të kalldrëmta
Një hije e ylbertë mbuloi Prizrenin
Pranë Urës së Gurit gugatje pëllumbash

NJERIU DHE PASIONET

Jetoj duke ecur vertikalisht
Mes dy pasioneve
Njëri buzëqesh
Kurse tjetri veshur me trishtim
I mohon të gjitha ëndrrat e mia

Kjo bashkëjetesë nuk di se në çka ngjan
Por njëri pasion
Egërsisht kundërshton tjetrin
Që i përngjan gurit që hesht

Njeriu dhe pasionet
Lumenjtë që derdhen në të njëjtin det
Por kurrë nuk takohen
Të bisedojnë me shungullimën e erës

NUK DI

Nuk di
A kanë shkak dëshirat
Ose ne vetë jemi shkaku i dëshirave

Dora e djathtë e kruan të majtën
Kurse që të dy duart
S'janë në gjendje ta kruajnë shpinën

Nuk di
Se pse ecja e jonë i përngjan hijes
Kurse ne nuk jemi as hije

NË LOTIN E ZHURIT

Kur trishtohen mjegullat
Ne i humbim rrugët
Si murgjit e dehur
Ecim drejtë një piramide
Puthim ndryshkun e kateteve

Më pastaj
Bisedojmë me sfinksin
Na duket si një lloj balsami
Era e dehur e shkretëtirës

Nga rrjeti i merimangës
Depërtojmë deri në brinjët
E shpellës së humbur
Dhe tretemi si milingonat
Në lotin e zhurit

Nëse nuk kemi punë më të mençur
Pyesim kaktusin
Për puthjen e shthurur të erës
Dhe nëpër dunat e përgjumura
I pjekim vezët
E breshkave të shkretëtirës

KUR MËSUAM ERËN E TEMJANIT

Më duket se jemi njerëz
Pa nocione
Në brinjët e trekëndëshit kënddrejtë
Puthim katetet e vdekura

Ecim udhëve që nuk kanë dalje
Nëpër eter deri në shfarosje
Vrapojmë pas një ideje
Që asnjëherë nuk i ka ngjarë idesë

Kur thash se jemi pa nocione
Në mendje e kisha mermerin e ftohtë
Nga i cili pjalmojnë
Lotët e përditshme të kallkanëve

Posa e mësuam erën e temjanit
Na shpallën njerëz pa nocione
Dhe që nga ajo kohë e deri më sot
Po u përngjajmë
Murgjve ngarkuar me mëkate

Prishtinë, 12 janar 2014

Cikli i tretë

QË NË LOTIN E ACARIT

Ndoshta vetëm juve
U takojnë privilegjet të jeni të trishtuar
Nën mëngët e këmishës
Asnjëherë s'pushojnë së kafshuari
Erërat e çmendura të jetës

Me një koçan misri në trastë
Jeni në gjendje
Që në lotin e acarit
Ta përballoni fërfëllizën
Më të madhe të dimrit
Gjumi i juaj nuk ka asgjë me makthin

Herët në mëngjes zgjoni trishtimin
Dhe gjatë tërë ditës
Pa ngrënë e pa pi
Bashkëjetoni nëpër stacion trenash

Vetëm lavjerrësi i orës
Dhe një qen endacak
I njeh hallet e juaja

Por për një gjë ju kam lakmi
Ka diçka hyjnore dhe madhështore
Në qenien e juaj

Jetën e kaloni pranë kontejnerëve
Por ajo që ju mbanë gjallë
Është shpresa e së nesërmes
E cila aq shumë
Tepër shumë u mungon të tjerëve

SI NJË NOCION I LARGËT

Sa keq po më sëmbojnë
Kallkanët e kësaj çatie
Ani se nuk jam mësuar të qaj
Disi lotët po lindin nga guri
Dhe derdhen
Rreke mollëzave të fishkura

Ky dimër që nuk po i përngjan
Dimrave të kaluar
Mbase ka mbetur vetëm
Si një nocion i largët
Po ndryshon nga stinët e tjera

Ja shikoni se si kam mbetur
Si një kërcu
Diku mes ëndrrave
Dhe zhgjëndrrave të largëta
E kthej kokën pas
Shoh vetëm një boshllëk të thellë

Më duket se kjo siluetë qenka e verdhë
Ose nuk paska kurrfarë ngjyre
Qenka skajshmërish e tejdukshme
Dhe po zgërdhihet me një ironi të paparë
Me bastunin e gjyshit tim

NJË DRU I VETMUAR

Në një stacion trenash
Mbrëmë rastësisht u takova
Me platformën e kujtesë
Ora e vjetër gozhduar për muri
Qante
Qante si kryqi pranë një gur sinori

Ishte natë e errët meteorët pikonin
Si stërkala shiu
Binin diku
Nëpër ëndrrat e fëmijërisë
Pa reshtur binin edhe yjet

Një erë e acartë frynte nga veriu
Loti ngrihej në sy
Pemët i kishin lëshuar flamujt
Dhe parakalonin
Me palltot e shqyera të stinës

Ky vrushkull pjalmuese prej lotëve
Sa shumë po i përngjan
Fëmijërisë sime
Një dru i vetmuar te varret e kishës
Si një qilimi i braktisur
Qante me ngashërim

KUR QANTE MALI

Ishin kohërat e vështira
Patëm edhe ditë pa ëndrra
Gjumin nuk e bënim gjumë
Flinim si kuajt e arabaxhiut

Ëndrrat tona
I përngjanin atyre të drurëve
Herë kishim zjarrmi
E herë na ngrihej frymëmarrja

Kur qante mali
Çaheshin edhe lisat shekullor
Bari nën rrënjët e lodhura të rrapeve
Asnjëherë nuk arriti të eci si lisat

BASTUNI I LAKUAR

Në errësirë marrim rrugë
Ecim drejtë një drite
E cila askund nuk duket
Asnjë tunel para nesh

Ecim si nata
Pranë hijeve tona imagjinare
Me një bastun të lakuar
Ecën pa qëllim edhe sterra

Ecim ose vendnumërojmë
Në fund të tunelit
Sërish një trishtim prej errësire
Pa asnjë shpresë ecën një hije pas nesh

Nata njerëzit dhe një grusht drite
Që s'duken askund
Ecin e s'ndalen në asnjë tunel
Ne sërish jemi në ecje e sipër

QYTETI PA EMËR

Nuk ishim ne fajtor
Që nuk trokitëm në asnjë portë
S'trokitëm
Sepse nuk ishin të mbyllura

Hymë në një rrugë të zbrazët
Asnjë derë e dritare s'pamë
Si milingonat ecnin tjegullat
Nuk ndaleshin as sokakët

Kush banon në këtë qytet pa emër
Asnjë zë s'përgjigjet nga brenda
vetëm zëri i shurdhër i këndesit
E zgjon mëngjesin e fjetur

Trokasim në dyert e hapësirës
As yjet nuk na i hapin portat
Kalojmë rrugëve të kalldrëmta
Qeshin me ne çatitë e shekullit të kaluar

KËMISHA E SHPRESËS

Sivjet si kurrë më parë
Po i dëgjojë zërat e gjyshërve
Si në ndonjë kor antik
Dëgjohen hapat e erës
Kah rrapëllojnë
Si portat e vjetra të qytetit

Mbi çatitë e rrënuara
Dëgjohen edhe krakëllimat
E korbave
Hëna ka dal te majat e maleve
Dhe si Penelpoa e bukur
End këmishën e shpresës

O vetëm edhe pak durim
Thoshin pleqtë
Vetëm edhe pak ka mbetur
Deri në mëngjes
Kuajt e shaluar të luftës
Që me kohë janë përgatitur
Për maratonën përfundimtare

FLUTUROJNË DERISA VDESIN

Njerëzit e babëzitur
Kalojnë si hijet andej rrugës
Me hapa të shthurura
S'dinë të ndalen erërat
Nuk janë në gjendje të kuptojnë
Athua janë të uritur ose të verbër

Ecin ngjashëm me zogjtë e shurdhër
Kur çelin vezët
Ecin me sy të mbyllur
Marrin frymë si peshqit

Me hapa të rënda kalojnë
Mbi kufoma njerëzish
Dhe shtypen nën presionin
E ingranazheve të erës

Më pastaj
Depërtojmë nëpër atë zallahi
Deri te pamjet që rrallëherë përsëriten
Nuk di më
Se kujt i përngjajnë
Por më së paku njeriut

Ecim pranë kafshatave të karbonizuara
Prej fytyrave tona
Pikojnë djersët e përhirtë
Pikon një trishtim i paparë
Deri më sot

Nga trutë e dehidruar
Zbresin drurët
Akoma pa mbërri në çerdhe
Fluturojnë si zogjtë e verbër
Fluturojnë derisa vdesin

Prishtinë, 13 janar 2014

LËRENI ZËRIN TIM

Jam lodhur nga këto britma
Lëreni zërin tim
Lëreni se do çmendem si furtuna

Mbi çdo gjë sonte po bie shi
Trishtueshëm
Po lagen kordhat e zërit

Janë të hapura rrugët e juaja
Mund të fluturoni ku të doni
Mua më mbanë gjallë
Një nostalgji
Ndoshta më mundon e kaluara

Sa e mirë ishte ajo kohë
Që punohej diçka keq
E jo si kjo e sotme përtace
Ngarkuar me apati

Lëreni rehat orën në stacion
Lavjerrësi akoma lëviz në të dy kahet
Kurse zëri im
Ka mbetur peng në brendinë e shinave

Mes këtyre trenave të ndryshkur
I përngjan mermerit që hesht
Çfarë të bëjë me duart e mjegullave
Kur shoh
Se si vdesin për çdo ditë nga pak

NA U THYEN TË GJITHA KODET

Nuk dihet më se kush jemi
Dhe ku jemi
Kjo shakullinë e ndërgjegjes
Për çdo ditë nga pak po gërryen dheun
Nën këmbët e pasigurta të atdheut
S'ndalen të lehurat e ujkonjave

Kjo rrjedhë e pandalshme
Depërton deri në ashtin e rrashtës
Trutë kundërmojnë
Një erë të rënd kundërmon
Shpirti i dërmuar
Për çdo ditë
Po zhbëhet njeriu deri në asgjësim

Disa lloje gurësh na rënë mbi kokë
Shqipëria po lëngon
Rënd po lëngon në altarin e vdekjes
E mbyti prostitucioni
Po ngufatet nga droga
Atdheu i jonë i frikësuar

Na u thyen të gjitha kodet e burrërisë
Namin dhe famën
E përpiu djalli i zi

Për një lek
Ndërrojmë emër komb dhe fe
Jugun e morri lumi
Veriun Drini
Heu ç'po ndodh me ne Shqiptari

SHELGU I PIKËLLUAR

Këto ngrehina asnjëherë nuk ishin
Këndej pari
Në këtë vend
Kullosnin kuajt gërdallë të ikur nga lufta

Që i shalonin
Disa njerëz sa grotesk
Po aq edhe të trishtuar

Mbase ndryshuan këtu gjërat
Erdhën disa njerëz të huaj dhe mbollën
Shelgje të pikëlluara

Edhe në sytë tanë të lëbyra
Me gjasa mbollën njëfarë peme
Që asnjëherë nuk përjetoi lulëzimin

Kanë ndryshuar imazhet e së kaluarës
Këtu dikur ishte lama e drithit
Atje më poshtë te lagja e evgjitëve
Shiteshin drutë dhe pemët vjeshtore

Por sot më duken të rënda këto ndryshime
Edhe njerëzit që enden këndej pari
Nuk janë miqtë e mi

Merren vesh në një gjuhë të huaj
Të cilën ne nuk e kuptojmë
Dritaret dhe shpresat
I kanë të drejtuara kah qielli

Prej disa bombolave me gaz
Marrinë frymë si peshqit artificial
Kanë një ecje kuajsh
Thua se kanë zbritur nga përrallat

MUNGESA E JOTE

Akoma pa trokitur në dyert e kësaj bote
T'i kam dëgjuar të qarat
Jashtë mureve konkave të dhomës
Çirrej një erë e çmendur

Të reshurat nuk dinin të ndalen
Po bien si në kohë pranvere
Kurse sot është dimër
Nëpër qoshet e dhomës së fjetjes
Si kuajt e egër vrapojnë furtunat

I gozhduar si një kryq prej druri
Jam ngulitur në një kënd
Dhe nga shtrati
I shikoj fotografitë
E miqve që rrinë gozhduar në kornizë

Nuk di më
Se çka më mungon në këto çaste
Mungesa e jote
Po ma tregon fundin e rrugës

DUKET SI NJË GJYLE

Njerëzit në qytetin tim
Zgjohen të trembur si zogjtë
Janë të çuditshëm
Ecin me shpirt të ngarkuar me ankthe
Nuk e njohin as vetveten

Trokasin nëpër dyert e mbyllura
Sepse vet këta njerëz
Mbyllën çdo gjë
Po ashtu siç i mbylli Uliksi
Veshtë e miqve të vet me dyllë

Asnjë dritare nuk hapet sonte
I kanë mbyllur me shula druri
Edhe deriçkat e erës
Me gishta të nxira nga nikotina
I mbyllë shqisat e të dëgjuarit

Çdo hapësirë edhe më e vogla
Nuk ka shans të duket ndryshe
Sonte çdo pjesë e qytetit antik
Duket si një gjyle
E ngujuar në grykën e topit

NUK JEMI MË ESËLL

Më duket se jemi të huaj për njëri - tjetrin
Flemë lakuriq por lëkura e jonë
Nuk e ka aromën e tokës
Mëngjeseve herët e zgjojmë këndesin
Dhe i shpërlajmë sytë
Me vesën e mekur të agullimës

Pasditeve kalojmë prej një ane
Në anën tjetër
Të mendimeve të shthurura
Nuk jemi këmbëngulës
Për një gotë vere lëshojmë pe
Pastaj më vonë nuk e njohim as vetveten

Ka raste kur i përngjajmë makthit
Netëve sterrë grindemi me ëndrrat tona
Kur zgjohemi
Nuk jemi më esëll
Pa pirë alkool dukemi të dehur
Sytë tanë të ënjtur skuqen
Nga një sëmundje e panjohur

NËPËR KËTO STOLA

Kjo kafene që s'bëzan sonte
Jeton me një ëndërr të trishtuar
Këto tavolina të papastra
Ndoshta kanë mbetur pa kujtesë

Por mua më kujtohet çdo imtësi
Çfarë ka ndodhur kur deheshin netët
Kush nuk është ulur
Nëpër këto stola
Prej ushtarëve të dështuar
Deri te gjeneralët skizofren

Prostituta të çdo lloji dhe kalibri
Murgj të pashpresë
Me nga një gjysmë kryqi
Dhe hoxhallarë pa çallma duke thithur
Disa lloje gjethesh me nargjile

Çfarë nuk pashë në këtë kafene
Buzë rrugës
Vajza të reja me gjinj prej plastike
Dhe murgesha të ngarkuara me vite
Duke shitur lule të fishkura
Dhe mish njeriu

Prishtinë, 14 janar 2014

SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990*, nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në

librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar "Fahri Fazliu", në Kastriot.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.

15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013

79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot
86.**”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87.**”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88.**”Sytë e gurtë të erës”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89.**”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”** Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot , 2014
91.**”Krakëllimat e natës”**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. **“Ndjekësit e enigmave”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
93. **“Atdheu i paçmuar”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

94.**”Psalm i harruar ”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. ” Stina asnjanëse” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101**. “Druri i pikëlluar”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri” ,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

PËRMBAJTJA

Ky tren i çmendur i marsit - Cikli i parë 9
Vargu im 11
2. 13
3. 14
Të pres 15
Gjerdane të kristalta lulesh 16
Shirat e një vjeshte 17
Eja miku im 18
Jam ose duhej të isha 19
Me avion prej letre 21
Sërish për stinët në qytetin tim 23
Ëndrra 25
Ende kjo fotografi 26
Atë mal prej guri 27
Kur më nuk do të jem 28
Unë nuk i besoj askujt 29
Asnjë ëndërr nuk më vjen 30
Po thonë meteorologët 31
Ky tren i çmendur i marsit 32
Në ballë me varrtarin 34
Kohërat që nuk harrohen - Cikli i dytë 35
Kujt po i mbetet ky atdhe 37
Sonte 39
Dita e mbarë 41
Përpos të frymojmë 42
Jashtë kësaj beteje 43
Askush nuk banon aty 45
Kur kthehen 47
Muzika e ciganëve 48

Nuk ndalen as patat e egra 50
Çelësi i kërkesave tua 51
Si fëmijë kënaqem 53
Kohërat që nuk harrohen 55
Njerëzit pa fije shprese 56
Sërish për ciganët 57
Motra e kujtesës 58
Flokët e erës 59
Kodi i familjes 61
2. 62
Nuk i përngjaje askujt 63
Mbi çatitë e Lumëbardhit 65
Njeriu dhe pasionet 66
Nuk di 67
Në lotin e zhurit 68
Kur mësuam erën e temjanit 69
Lëreni zërin tim - Cikli i tretë 71
Që në lotin e acarit 73
Si një nocion i largët 75
Një dru i vetmuar 76
Kur qante mali 77
Bastuni i lakuar 78
Qyteti pa emër 79
Këmisha e shpresës 80
Fluturojnë deri sa vdesin 81
Lëreni zërin tim 83
Na u thyen të gjitha kodet 85
Shelgu i pikëlluar 87
Mungesa e jote 89
Duket si një gjyle 90
Nuk jemi më esëll 91
Nëpër këto stola 92

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Lëreni zërin tim / Adem Zaplluzha. - Kastriot : Shtëpia botuese “ Fahri Fazliu”, 2014. - 101 f. ; 21 cm.

Shënime biografike për autorin : f. 93 -101

ISBN 978-9951-664-13-4